



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 585, datë 09.10.2024

PËR

**RRITJEN E NUMRIT TË GJYQTARËVE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE
TË APELIT DHE RITJEN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË GJYQTARËVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 14, 15 pika 3, shkronja b, 21, 22 dhe 90 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 09.05.2024 "Për miratimin e raportit vlerësues të grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë", me propozim të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Të propozojë rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit nga 13 në 22 gjyqtarë.
2. Të propozojë rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë nga 408 në 417 gjyqtarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR